**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Sektorit Financiar të Kosovës.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Për:

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për Programin e Kredisë të Bazuar në Politika.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Për

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Nr. 03/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW, Frankfurt am Main, për Programin e Kredisë të Bazuar në Politika në Sektorin e Energjisë dhe Klimës për Kosovën.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Për

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Projektin "Lehtësimi i Tregtisë dhe i Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0".

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Për:

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 95, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, të nenit 3, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Lista e Artikujve për Përdorim të Përbashkët, që janë Objekt i Procedurës Qendrore të Prokurimit Publik, e bashkëngjitur në Shtojcën e këtij Vendimi.

2. Obligohen Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të bëjnë shpalljen e këtij Vendimi, sipas nenit 95, paragrafi 2, të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

3. Obligohet Agjencia Qendrore e Prokurimit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Për:
___________________________
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

## Shtojca I

### Artikujt dhe Shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

| Përshkrimi i artikullit | Lloji i kontratës | Kohëzgjatja |
|---|---|---|
| 1. Furnizim me letër për kopje | Kontratë Kornizë | 2 Vite |
| 2. Furnizim me material zyrtar | Marrëveshje Kornizë | 3 Vite |
| 3. Furnizim me vetura | Kontratë Kornizë | 1 Vit |
| 4. Furnizim me artikuj ushqimor | Kontratë Kornizë | 2 Vite |
| 5. Furnizim me mobile | Marrëveshje Kornizë | 3 Vite |
| 6. Furnizim me pajisje të teknologjisë informative (Marrëveshje kornizë) | Marrëveshje Kornizë | 3 Vite |
| 7. Furnizim me pemë dhe perime (Marrëveshje kornizë) | Marrëveshje Kornizë | 3 Vite |
| 8. Veturat me qira | Kontratë Publike Afatgjate | 5 Vite |
| 9. Furnizim me karburante | Kontratë Kornizë | 1 Vite |
| 10. Furnizim me mazut | Kontratë Kornizë | 2 Vite |
| 11. Furnizim me ujë të pijes | Kontratë Kornizë | 3 Vite |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/06
Datë: 27.03.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohen ndryshimet në Tabelën 3.2 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026, me qëllim të përmbushjes së obligimeve financiare dhe kontraktuale, të papërmbushura nga viti paraprak për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me Tabelën nga pika 1. e këtij Vendimi, t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.

3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Tabela 3.2 - Ndryshimet me nenit 8 pargarfi 2 të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, për Ministrinë e Mbrojtjes.

| BLLOKU_KODUES | ORG | ORGANIZATA | NEN-PROGRAMI | KODI I PROJEK | EMRI I PROJEKTIT | BUXHETI_AKTUAL_2026 | NDRYSHIMET PLUS/MINUS | GJENDJA E MBETUR PAS NDRYSHIMEVE BUXHETORE ME NENIN 8 TË LB 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| 10/217/36000/30/19071/0210 | 217 | MINISTRIA E MBROJTJES | FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS | 19071 | NDËRTIME DHE RENOVIME | 17,945,000.00 | 20,500,000.00 | 38,445,000.00 |
| 10/217/36000/30/19072/0111 | 217 | MINISTRIA E MBROJTJES | FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS | 19072 | SISTEME, PAJISJE DHE ARTIKUJ PËR MBROJTJE | 71,821,193.80 | (20,500,000.00) | 51,321,193.80 |